

PROCESVERBAL
nga vazhdimi i parë i seancës së 3-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
mbajtur më 11.07.2025

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video konferencë: mr. Sasho Stefanovski, Zirjeta Jajaga, Gordana Majnova, Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska, Petar Xhurovski, Viktor Pavlovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nëpërmjet lidhjes video konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të pranishëm nga Shërbimi profesional nëpërmjet lidhjes video konferencë: Dimitar Tanurov, Cvetanka Mitrevska, Goran Radunović, mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit mr. Sasho Stefanovski, hapi vazhdimin e parë të seancës së 3-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 11:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video konferencë.

Z. Stefanovski shpjegoi se në këtë seancë do të shqyrtohet Propozim – procesverbalin nga seanca e dytë, mbajtur më 7 korrik 2025, i cili ishte shtyrë paraprakisht për shkaqe teknike – përkatësisht, nuk kishte kohë të mjaftueshme për përgatitjen e tij, pasi të dy seancat u mbajtën në të njëjtën ditë, njëra pas tjetrës.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Propozim-procesverbalin nga seanca e 2-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 07.07.2025.

Këshilltarja Afrona Vërzivolli kishte një vërejtje teknike për Procesverbalin e propozuar. Ajo tregoi se në fillim të Procesverbalit, në pjesën ku evidentohen anëtarët në mungesë të Këshillit, pranë emrit të anëtarit në mungesë duhet të citohet dhe arsyeja për mungesën e tij. Kjo është në pajtim me Rregulloren e Punës së Agjencisë, që parasheh se arsyeja për mungesë duhet të jetë cituar qartë.

Z. Stefanovski informoi se anëtari i Këshillit, që mungonte në seancë, dorëzoi Deklaratë me arsyetim për mungesën e tij. Më pas propozimi i znj. Vërzivolli – që pranë emrit të anëtarit në mungesë të citohet dhe arsyeja për mungesë – ishte vënë në votim.

Me 2 vota „pro“ nga anëtarët Afrona Vërzivolli dhe Petar Xhurovski, nuk u pranua propozimi për plotësimin e Procesverbalit të propozuar.

Këshilli i Agjencisë me 6 vota „pro“ dhe një abstenim nga Viktor Pavlovski miratoi Procesverbalin nga seanca e 2-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 07.07.2025, me tekstin e propozuar.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,**

Mr. Sasho STEFANOVSKI